



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Leje Ndërtimore



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/03-1866

Dt.23.05.2024.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 dhe Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura, lëshon këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	"SunVolta Energy" SH.P.K. me NUI 810053819, me seli në Prishtinë.		
Adresa:	Rruga "Ekrem Rexha, C1C, B4, Prishtinë.		
Telefoni:	045 667 511	Emaili:	

Emri i Projektit:	Ndërtimi i sistemit solar, me kapacitet 15 kWp, konform Pëlqimit nga KEDS nr. 962 dt. 29.01.2024, në objektin shkollor P .		
Emri i Projektuesit:	"Sun Volta Energy" SH.P.K. me NUI 810053819, me seli në Prishtinë.		
Adresa:	Rruga "Ekrem Rexha, C1C, B4, Prishtinë.		
Telefoni:	045 667 511	Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim:			
Adresa: Rruga "Nomalja e Gjakovës "- Gjakovë .			
Zona(t) Kadastrale: Gjakovë-Qytet	Nr. i parcelave kadastrale: 01166-1		GPS Koordinatat:

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtim i ri ☒	Rindërtim ☐ Riparim ☐
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I ☒	Kategoria II ☐
Përdorimi i propozuar:	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po ☐ Jo ☒
Përshkrimi:	
- Lejohet Ndërtimi i sistemit solar, me kapacitet 15 kWp, konform Pëlqimit nga KEDS nr. 961 dt. 29.01.2024, në objektin shkollor SH.M "KADRI KUSARI"-Gjakovë .	

- **Obligohet pala qe pas pranimit te Lejes Ndërtimore – Instalimit te paneleve të siguron pëlqimin nga ZRRE, dhe me te njëjtin të informon DUMM-në dhe KEDS.**

Me këtë vendim, **“Sun Volta Energy” SH.P.K. me NUI 810053819, me seli në Prishtinë**, i lejohe Ndërtimi i sistemit solar, me kapacitet 15 kWp, konform Pëlqimit nga KEDS nr. 961 dt. 29.01.2024, në objektin shkollor SH.M “KADRI KUSARI”-Gjakovë, në parcelat me nr. 01166-1: Gjakovë-Qytet dhe njëkohësisht obligohet pala qe pas pranimit te Lejes Ndërtimore –Instalimit te paneleve të siguron pëlqimin nga ZRRE, dhe me te njëjtin të informon DUMM-në dhe KEDS.

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë se saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelën informuese ne vend ndërtim me informatat e mëposhtme:
 - informata mbi Lejen Ndërtimore
 - informatat mbi projektuesin
 - informata mbi kontraktuesin
 - prezantimi grafik i dukjes se ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vend ndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - projektin kryesor me te gjitha faza për nevoja te realizimit te ndërtimit;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - protokollet e miratuara te nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzoj njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor te miratuara nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike ne fuqi;
 - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesi – “Sun Volta Energy” SH.P.K. me NUI 810053819, me seli në Prishtinë, përmes kërkesës së evidentuar me nr. 07-351/03-1866 të datës dt.08.02.2024 të parashtruar DUMM-së, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për Ndërtimi sistemit solar, me kapacitet 15 kWp, konform Pëlqimit nga KEDS nr. 963 dt. 29.01.2024, në objektin shkollor SH.M “KADRI KUSARI”-, në parcelat me nr. 01166-1: Gjakovë-Qytet .

DUMM, përkatësisht zyrtari përgjegjës për lëndën, pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031 dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Plani i Situacionit 1: 500 i vërtetuar nga DUMM, dt.15.03.2023.
- Kopjen e planit së bashku me Certifikatën mbi të drejtën në pronë e paluajtshme (fotokopje) në pronësi SH.M “KADRI KUSARI”-Gjakovë të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
- Lejen Mjedisore komunale me nr, 07/351/02-7092, 17.05.2024, lëshuar nga DUMM.
- Marrëveshjen e bashkëpunimit me nr. 01, nr. 413/01-16729, dt. 28.08.2023, në mes të Komunës së Gjakovës dhe Fondacionit të Kosovës për shoqëri të hapur.
- Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë.
- Pëlqimit Elektroenergjetik, nga KEDS nr. 961 dt. 29.01.2024.
- Projektin kryesor, në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar nga “Sun Volta Energy” SH.P.K. me NUI 810053819, me seli në Prishtinë.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim.

Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.


Nga një kopje të këtij vendimi t’i dërgohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë për Punë Inspektuese,
- Arkivit.


Zyrtari përgjegjës për lëndë
Elida Bejtullahu I.D.A.


Hartoi aktin
Zenel Shabani Z.L.Ligjor




Drejtori
Arben Bakalli